

V E N D I M
Nr. 425, datë 12.9.2002

PËR RITJEN E PAGESËS KALIMTARE TË USHTARAKËVE NË REZERVË (LIRIM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18 dhe 21 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar”, ndryshuar me ligjin nr.8521, datë 30.7.1999, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Rritjen në masën 10 për qind të pagesës kalimtare që përfiton ushtaraku në rezerë (lirim) në zbatim të shkronjës “b” të nenit 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, me ndryshimet përkatëse.

2. Përfitojnë nga kjo rritje ushtarakët e nxjerrë në rezervë (lirim) nga strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.

3. Efektet financiare të përballohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002, miratuar për institucionet përkatëse.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2002.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano